

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kitarat e Johnny Marr shiten në ankand për gati 4.6 milionë euro
ADRESA	https://www.koha.net/showbiz/kitarat-e-johnnymarr-shiten-neankand-per-gati46-milione-euro
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 01:17:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 08:20:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	307c8d9d2086c9d05e520923a9c17a9cbfde6f8f658c2d6ded8e2f7af719e697
TEKSTI	623632000f9b6dd4889bc21ac37bf7a56a918452c9bbf1e84f0fa3be97b2e857
PAMJA	9477ab8a2298200fcd74a6fe62b97aef47f7bb74a78163cf3937d76c2e3fa502

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8f6b6ed51e0a40ae21d8dff667f4b0914861f05d8ed8ef086b3e04e663f282b3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9820c0ddeb45471f928207a963ca36ba3aaf52dec6ebed920f8d826671ee6c4b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8f6b6ed51e0a40ae21d8dff667f4b0914861f05d8ed8ef086b3e04e663f282b3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SHOWBIZ

Kitarat e Johnny Marr shiten në ankand për gati 4.6 milionë euro



18 shtator 2026 10:20

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Kitarat e përdorura dhe të koleksionuara nga Johnny Marr, ish-kitaristi i grupit legjendar britanik The Smiths, janë shitur në ankand për një shumë prej 3,6 milionë paund ose rreth 4.2 milionë euro.

Instrumentet, të cilat Marr i ka përdorur gjatë periudhës së tij me The Smiths, si dhe në punën e tij solo, u shitën në kuadër të ankandit të organizuar nga Christie's, me titullin "Marr's Guitars: The Johnny Marr Collection".

Ankandi zgjati më shumë se pesë orë dhe tërhoqi blerës nga 34 vende të ndryshme të botës. Shuma përfundimtare ishte më shumë se tri herë më e lartë se vlera e parashikuar fillimisht për koleksionin, [raporton BBC](#).

Duke komentuar shitjen, Johnny Marr, tani 62-vjeçar, u shpreh se ankandi kishte qenë një përvojë e jashtëzakonshme dhe se kishte tejkaluar të gjitha pritshmëritë e tij.

"Ankandi ka qenë një përvojë e mrekullueshme dhe ka tejkaluar të gjitha pritshmëritë e mia. Dua të falënderoj të gjithë ata që bënë oferta dhe, në veçanti, Christie's që e bëri këtë përvojë kaq të paharrueshme", tha Marr.

Edhe

**Kulturë** • 3 sht 2026

Piktura e grabitur nga nazistët, në ankand me çmim fillestar 25 milionë euro

Kitara "Rickenbacker 330", e zezë me shkëlqim, e vitit 1982, në pronësi të Marr, u shit për 358 mijë e 400 paund, ose rreth 417 mijë euro, pas një beteje mes ofertuesve që zgjati më shumë se pesë minuta.

Marr këtë kitarë e përdori gjatë gjithë procesit të regjistrimit të albumit debutues të The Smiths, si dhe gjatë turneve të para të grupit. Ajo mund të dëgjohet në këngë të njohura si "This Charming Man", "Still Ill" dhe "What Difference Does It Make?".

Kulturë.

"A Chip Odyssey" dekodon frymën e zhvillimit të Tajvanit

Arbëri.

Jashari: Kosova duhet të sillet si e rritur karshi Evropës dhe Amerikës

Arbëri.

Jashari: PDK-ja duhet ta ketë Ministrinë e Drejtësisë

Futboll.

Brentfordi turpëron Chelsean

LAJMET E MBRËMJES.

Bashkëpunëtorë dhe bashkëveprimtarë e kujtojnë kontributin e Flora Brovinës

Futboll.

Bayerni me fitore 7:0, Kane vendos rekord

Instrumenti u shfaq gjithashtu në kopertinën e këngës së parë të rock grupit anglez Oasis, “Supersonic”.

Marr ia kishte huazuar kitarën anëtarit të këtij grupi Noel Gallagher, gjatë sesioneve të para të regjistrimit të albumit debutues të grupit “Definitely Maybe”.

Një tjetër kitarë, “Gibson ES-355” e vitit 1960, në ngjyrë të kuqe, në pronësi të Marr, u shit për 204 mijë e 800 paund, ose rreth 238 mijë euro.

Ky instrument e frymëzoi Marr për të shkruar muzikën e këngës “Heaven Knows I’m Miserable Now” që The Smiths e publikoi në vitin 1984.

Kitarën ia bleu në vitin 1983 themeluesi i kompanisë diskografike “Sire Records”, Seymour Stein, pasi Marr bëri shaka se The Smiths do të firmosnin kontratë me kompaninë nëse Stein do t’i blinte një kitarë të re.

Ankandi u zhvillua pak para publikimit të albumit të parë të Marr në katër vjet, “The Age Of Everything”, i cili pritet të publikohet më 2 tetor.

Edhe



Auto • 17 gus 2026
Vetura e parë elektrike e Ferrarit shitet në ankand për një rekord prej 40 milionë dollarësh

Marr ishte kitaristi dhe bashkautor i këngëve të The Smiths, së bashku me këngëtarin Morrissey.

Grupi nga Mançesteri publikoi katër albume në studio përpara se të ndahej në vitin 1987, duke u bërë një nga grupet më të rëndësishme të skenës britanike.

- #JOHNNY MARR
- #KITARAT
- #ANKAND

Artikuj të ngjashëm



Showbiz • 16 gus 2026
Shoku i Amy Winehouse rikthen në ankand sendet e këngëtares



Kulturë • 12 gus 2026
Tri vepra të Banksyt i kushtojnë Britanisë mbi 170 mijë euro t’i mirëmbajë



Showbiz • 30 kor 2026
Babai i Amy Winehouse urdhërohet t’u paguajë mbi 1.1 milionë euro dy shoqeve të këngëtares

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe Interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzim për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.